



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1035/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Afijete Sada Gllogjani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Ilmi Reçica nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1035/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Ilmi Reçica nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave Qendrat e Votimit: Shkolla “Iliria” Prishtinë, Mramor Shkolla “Avni Rustemi”, Shkolla Ekonomike “Hoxhë Kadri Prishtina”, Shkolla “Teuta”, Grashticë, Shkolla “Zenel Hajdri”, Prishtinë Shkolla “Asim Vokshi”, Shkolla “Faik Konica” Prishtinë dhe Shkolla “Elena Gjika”.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Ilmi Reçica nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në Qendrat e Votimit: Shkolla “Ilira”, Shkolla “Avni Rustemi”, Shkolla Ekonomike “Hoxhe Kadri Prishtina”, Shkolla “Teuta”, Shkolla “Zenel Hajdri”, Shkolla “Asim Vokshi”, Shkolla “Faik Konica” dhe Shkolla “Elena Gjika”, për arsye janë shkelur dispozitat ligjore dhe i mungojnë shume vota andaj kërkon kthimin e votave të tij.

Ka bashkangjitur deklaratat e 2 votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Ilmi Reçica nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë ka

paraqitur apel me të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në Qendrat e Votimit: Shkolla “Ilira”, Shkolla “Avni Rrustemi”, Shkolla Ekonomike “Hoxhe Kadri Prishtina”, Shkolla “Teuta”, Shkolla “Zenel Hajdri”, Shkolla “Asim Vokshi”, Shkolla “Faik Konica” dhe Shkolla “Elena Gjika”.

Paneli, vlerëson se sa i përket Qendrave të Votimit: Shkolla “Avni Rrustemi”, Shkolla Ekonomike “Hoxhe Kadri Prishtina”, Shkolla “Teuta”, Shkolla “Zenel Hajdri”, Shkolla “Asim Vokshi”, Shkolla “Faik Konica” dhe Shkolla “Elena Gjika”, parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Ndërsa paneli me rasti e vendosjes sa i përket Qendrës së Votimit 1915E Shkolla “Iliria” mori për bazë pretendimet e ankuesit se deklaratat e dorëzuar për QV-në e lartcekur janë dëshmi se ka pasur vota në atë QV, për panelin është e qartë se në këtë QV kandidati në fjalë ka pasur 21 dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shkresore ankuesi në QV-në e vendosur nuk i ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota se sa janë publikuar në rezultat përfundimtar, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1035/2021 më datën 07.11.2021



**Kryesuesja e Panelit
Afijete Sada Gllgjani**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.